



Republika e Kosovës / Republika Kosova / Republik of Kosova
Komuna e Podujevës / Opština Podujevo / Municipality of Podujeva

ZYRA E PERSONELIT

Nr.13-111- 44679
Podujevë,
Më:31.05.2016

Bazuar në Ligjin e Shërbimit Civil të Kosovës nr. 03/L - 149 të nenit 11 pika 1, si dhe të Urdhërësës Administrative për procedurat e rekrutimit Udhëheqësi i Personelit mori vendim të shpall:

KONKURS

Për plotësimin e vendeve të lira të punës

I.DREJTORIA E ADMINISTRATËS

POZITA : Arkëtar - një (1) ekzekutues
KOEFICIENTI : 5
LLOJI I POZITËS : I karrierës
ORARI I PUNËS : 40 orë në javë
MBIKËQYRËSI : Udhëheqësi i Sektorit dhe Drejtori

Përshkrimi i detyrave të punës:

-Menaxhon dhe mirëmbanë të gjitha transaksionet e parasë së gatshme në institucion

-Kujdeset për sigurinë e të gjitha parave të gatshme në institucion

-Planifikon dhe kontrollon të gjitha shpenzimet e parasë së gatshme

-Mban evidenca për shpenzimet e parasë së gatshme dhe i sistemon në regjistrator përkatës

-Rishikon raportet,format,dhe të dhënat për saktësinë,plotësinë,dhe përputhshmërinë e tyre lidhur me shpenzimet e parave të gatshme

-Përgatitë raportet e parave të imta,dhe përgatitë raport lidhur me gjendjen e arkës

-Kryen dhe detyra tjera në përputhje me ligjet dhe rregulloret të cilat mund të kërkohen në mënyrë të arsyeshme kohë pas kohe nga mbikëqyrësi

Kualifikimi i kërkuar
-Fakulteti Ekonomik

Përvoja
-Së paku 4(katër) vite përvojë pune

Aftësia gjuhësore
-Njohja e gjuhës shqipe dhe serbe

INFORMATË E PËRGJITHSHME PËR TË GJITHË KANDIDATËT

Administrata e Kuvendit të Komunës ofron mundësi të barabarta punësimi dhe i mirëpret kërkesat e pjesëtarëve të komuniteteve jo shumicë dhe të femrave Kandidatët e përzgjedhur në listën e ngushtë do t'i nënshtrohen intervistimit . Konkursi mbetet i hapur 15 ditë nga data e shpalljes në mjetet e informimit publik dhe në tabelën e shpalljeve.

Fletëaplikacionet merren në Qendrën e shërbimit për qytetarë, në ndërtesën e Kuvendit të Komunës.

Kërkesat me dokumente të kompletuara dorëzohen në Qendrën e shërbimit për qytetarë .

Kërkesat e kandidatëve me dokumente të pakompletuara dhe ato që arrijnë pas afatit nuk do të merren në shqyrtim

Për çdo informatë plotësuese mund të kontaktoni në Zyrën e personelit, në këtë numër të telefonit 038/ 570 – 732 / lok .126.

